



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit:22.24.1-2010.08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
VUSHTRISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2010**

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje	5
II. Opinioni i auditimit.....	7
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	7
IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar.....	8
V. Pasqyrat financiare.....	9
V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm.....	9
V.2 Cilësia e informatave	10
VI. Realizimi i Buxhetit.....	10
VI.1 Të hyrat.....	10
VI.2 Shpenzimet.....	12
VI.3 Subvencionet dhe transferet.....	16
VI.4 Pasuritë dhe Borxhet.....	17
VII. Kontrolli mbi menaxhimin.....	19
VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm.....	19
VII.2 Auditimi i Brendshëm.....	19
VIII.Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës.....	20
Shtojca I. Komentet e Komunës së Vushtrrisë dhe përgjigjja e ZAP-it.....	21
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opioneve të Auditimit.....	21

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
APP	Agjencia për Prokurim Publik
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BpB	Banka Private e Biznesit
DRKS	Drejtoria për Rini , Kulturë dhe Sport
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
QKMF	Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Gjatë formulimit të opinionit ne vlerësuam mjaftueshmërinë e prezantimit të informacionit në pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe llogarit e arkëtueshme është jo i plotë dhe i pasaktë.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe llogarive të arkëtueshme nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të raportit, të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti për të përmirësuar performancën e organizatës.

Për vitin 2009 ishin dhënë pesë rekomandime. Prej tyre një ishin adresuar plotësisht ndërsa katër të tjera janë në proces të adresimit.

Rekomandimi ynë kryesor është që Kryetari i komunës të bëjë analiza të hollësishme të gjetjeve të këtij raporti dhe të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të vendosur masa adekuate për të përmbushur rekomandimet e dhëna në këtë raport. Një plan veprimi i specifikuar me afate kohore dhe bartësit e detyrave, do të ishte mekanizmi kryesor për arritjen këtyre objektivave.

Ne rekomandojmë që veçanërisht të siguroni:

- Implementimin e rekomandimeve të dhëna vitin e kaluar dhe këtë vit;
- Shpalosjen e plotë të llogarive të arkëtueshme;
- Respektimin e afatit kohor për kryerjen e punëve sipas kontratës;
- Regjistrimin në SIMFK të obligimeve të pa paguara;
- Se është bërë transferi i mjeteve të mbetura nga llogaria bankare private, në Llogarinë Kryesore të Thesarit dhe

- Regjistrimin e plotë të pasurisë.

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti.

Menaxhmenti i Komunës i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2010 dhe është zotuar që do ti bëjë përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e menaxhmentit të komunës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) 16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë për Komunën e Vushtrrisë.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës së Vushtrrisë. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar Pasqyrat Vjetore Financiare të komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse Pasqyrat Vjetore Financiare të MEF-it janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në komunë.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të komunës, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 2.

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe llogaritë e arkëtueshme është jo i plotë dhe i pasaktë.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe llogarive të arkëtueshme nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin tonë të auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të vitit 2009 janë dhënë pesë rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, një është adresuar plotësisht si përgatitja e PVF në dy gjuhët, ndërsa katër të tjera janë në proces të implementimit që ndërlihen me:

- Mbajta e regjistrave për debitorët;
- Shtimin e masave të kontrollit të brendshëm në fushën e prokurimit, duke respektuar plotësisht LPP;
- Menaxhimin e pasurive në pajtim të plotë me UA 21/2009; dhe
- Funkcionalizimin e Komitetit të Auditimit.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona, kanë shkaktuar të njëjtat probleme si në vitet e kaluara. Lidhur me këtë, ne shprehim shqetësimin tonë dhe shpresojmë që rekomandimet tona t'i adresoni plotësisht.

IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Shpenzimeve në pasqyrat financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve në euro (€)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar 2010	Buxheti i shpenzuar 2009
Granti i Qeverisë – Buxheti	8,136,326	8,339,397	8,822,226	8,793,559	7,696,470
Të hyrat vetjake	868,719	1,502,088 ¹	1,408,784 ²	1,086,515	1,098,920
Donacionet e vendit	0	0	158,879	74,917	147,400
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	9,005,045	9,841,485	10,389,889	9,954,991	8,942,790
Pagat dhe mëditje	5,096,022	5,362,393	5,538,537	5,500,157	4,890,560
Mallra dhe shërbime	930,930	918,019	927,752	888,289	946,330
Shpenzimet komunale	208,598	233,210	228,210	228,021	186,980
Subvencionet dhe transferet	150,000	155,000	156,010	155,822	116,660
Investimet Kapitale	2,619,495	3,172,863	3,539,380	3,182,702	2,802,260
Rezervat	0	0	0	0	0
II. Gjithsej shpenzimet	9,005,045	9,841,485	10,389,889	9,954,991	8,942,790

Nga tabela e lartë shënuar shihet se buxheti final për vitin 2010 për komunën e Vushtrrisë ka qenë 10,389,889€ dhe komuna ka shpenzuar 9,954,991€ apo rreth 95% të buxhetit final. Pjesa më e madhe e buxhetit është realizuar për investime kapitale dhe paga e mëditje. Po qe se krahasojmë me vitin 2009, shpenzimet e përgjithshme të komunës janë rritur rreth 11%.

Në kolonën e tretë të tabelës së dhënë, shihet se buxheti final ishte 10,389,889€ apo 1,384,844€ më i lartë se buxheti fillestar. Kjo për faktin se të hyrat vetjake dhe donacionet nuk ishin parashikuar me rastin e aprovimit të buxhetit. Ndërsa kategoria Granti i Qeverisë, sipas buxhetit final ishte 8,822,226€ apo 482,829€ më i lartë nga buxheti i rishikuar. Diferenca arsyetohet me faktin se MEF i kishte ndarë këto mjete komunës për investime kapitale 400,000€ dhe 82,829€ shujta të punëtorëve në fund të vitit.

¹ Të hyrat e planifikuara për vitin 2010

² Në këtë shumë janë përfshirë të hyrat vetjake të bartura nga viti 2009 në vlerë 317,771€ dhe të hyrat e inkasuara për vitin 2010 në vlerë prej 1,091,013€

Kemi vërejtur një tendencë të rritjes së shpenzimeve të investimeve kapitale në fund të vitit financiar. Vetëm në tremujorin e fundit ato arrinin në 50% të shpenzimeve të përgjithshme të kësaj kategorie.

Konkluzion

Shkalla e ekzekutimit të buxhetit prej 95% është një tregues i performancës së mirë buxhetore. Ndërsa shpenzimi i buxhetit për investime kapitale prej 50% vetëm në tremujorin e fundit, tregon se ekzistojnë kontrole të dobëta në vijimësinë e këtyre shpenzimeve në përputhje me objektivat e përcaktuara më herët nga entiteti.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të sigurojë:

- Se planifikimi është përmirësuar dhe janë ndërmarrë masa që do të siguronin shpenzimin e buxhetit në pajtim me planin.

V. Pasqyrat financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ 16/2010, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Komuna e Vushtrrisë ka përgatitur Pasqyrat Financiare në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ nr. 16/2010, përveç shpalosjes së llogarive të arkëtueshme dhe pasurive;
- Pasqyrat vjetore financiare të Vushtrrisë janë përgatitë në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Pasqyrat financiare janë nënshkruar dhe dorëzuar në Thesar me 31 Janar 2011 nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Pasqyrat Financiare janë përgatit në gjuhën shqipe dhe serbe;
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte financiare të rregullta tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2010.

V.2 Cilësia e informatave

Gjatë procesit të auditimit, kemi kërkuar nga komuna që pasqyrat financiare të përgatitura më 31/01/2011 për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010 të korrigjohen sepse kishin disa gabime.

Pasqyrat financiare të komunës të korrigjuara, janë dërguar për herë të dytë në Thesar me 28 Mars 2011, mirëpo prapë kanë mbetur të pakorrigjuara disa gabime.

Pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit:

- Neni 15. Shënimi 27, Përmbledhja e pasurive jo financiare në pasqyra financiare nuk është plotësuar sipas UA nr. 16/2010;
- Shënimi 28, Të arkëtueshmet, nuk janë shpalosur sipas kërkesave të UA.

Konkluzioni

Dobësitë në kontrollet mbi raportimin financiar kanë rezultuar me një pasqyrim jo të drejtë dhe të saktë të të dhënave financiare.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë:

- Se me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare të përfillen të gjitha kërkesat që dalin nga UA (duke i përfshirë edhe shpalosjet), me qëllim që pasqyrat të prezantojnë drejtë pozitën financiare të komunës.

VI. Realizimi i Buxhetit

VI.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2010 ishin 1,502,088€ ndërsa të hyrat e përgjithshme të grumbulluara në llogari ishin 1,408,784€ Prej tyre, të hyrat vetjake të bartura nga viti 2009 ishin 317,771€ ndërsa të hyrat e mbledhura për vitin 2010 prej 1,091,013€

Në vijim do të prezantohen gjetjet kryesore që kanë rezultuar nga testimet tona për kategorinë e të hyrave.

Të hyrat nga tatimi në pronë

Të hyrat e planifikuara të tatimit në pronë për vitin 2010 janë 190,000€ kurse janë inkasuar 260,862€ çka rezulton se 37% ka rritje në krahasim me planin.

Përgatitja dhe lëshimi i faturave të tatimit dhe evidentimi i pagesave të tatimpaguesve bëhet nëpërmjet softuerit “Portax”, softuer i cili ende është në zhvillim e sipër. Zyrtarët komunal të tatimit në pronë nga ky softuer ende nuk mund të prodhojnë raporte të dëshirueshme që do të mundësonin menaxhimin më efikas dhe efektiv të informatave tatimore mbi pronën. Është me rëndësi të veçantë të theksohet se në situatën e tanishme, komuna nuk regjistron secilin transaksion individual të tatimpaguesve në pronë. Si rezultat i kësaj, nuk ishte e mundur të bëhen barazimet ose analizat për debitorë.

Taksat, ngarkesat për ushtrimin e veprimtarisë afariste-biznesit

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim realizon të hyra nga subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e vet në territorin e komunës.

Gjatë vitit 2010, kjo drejtori ka lëshuar 1359 vendime, me ngarkesë prej 178,504€ që duhet paguajnë subjektet afariste për ushtrimin e veprimtarisë.

Planifikimi i inkasimit të të hyrave nga ushtrimi i veprimtarisë afariste për 2010 ishte 120,000€ kurse janë inkasuar 153,233€ apo 28% më shumë nga plani.

Gjatë auditimit kemi bërë rishikimin e disa vendimeve që obligojnë subjektet afariste të paguajnë taksën komunale. Nga 24 vendime të lëshuara në shumën prej 7,680€ shlyerjen e borxhit të tërësishëm kanë bërë vetëm 11 tatimpagues me 4,128 € apo 54% nga vlera që janë ngarkuar me taksë. Në një rast kemi identifikuar se vendimi i taksapaguesit me aktvendim nr. 255 në shumën prej 160€ nuk është i evidentuar në regjistrin kontabël të llogarive të arkëtueshme.

Aktvendimi nr. 349 është lëshuar në NRB tjetër, kurse evidenca në bazën e të dhënave është me një NRB tjetër. Ngarkesa me aktvendim nr. 122 është 400€ kurse në bazën e të dhënave është 1000€

Gjatë rishikimit të disa dosjeve për lejet e biznesit, kemi vërejtur se 7 biznese, nga drejtoria për buxhet dhe financa kanë marrë certifikata se nuk kanë obligime ligjore komunale, edhe pse gjendja reale është se ato kanë obligime të pa paguara.

Llogaritë e arkëtueshme të taksave për ushtrimin e veprimtarisë afariste për 2010 janë 223,397€ apo 8% më të larta se sa të vitit 2009.

Taksa komunale për leje ndërtimi

Planifikimi i të hyrave nga dhënia e lejeve për ndërtim për vitin 2010 ishte 100,000€ kurse inkasimi është 91,024€ apo 91% nga planifikimi. Ne kemi vërejtur se:

- Nuk mbahet regjistër kontabël i llogarive të arkëtueshme për të hyrat që krijohen nga dhënia e lejeve të ndërtimit; dhe
- Në dy raste këstet në vlerë prej 21,813€ kanë mbetur për t'u paguar në vitin e ardhshëm. Këto nuk janë evidentuar në regjistrat kontabël të llogarive të arkëtueshme.

Taksa për regjistrimin e trashëgimisë

Nga testimet tona të mëtutjeshme, kemi identifikuar se zyrtarët komunal në 4 raste nuk kanë kërkuar nga tatimpaguesit vërtetime që kanë shlyer obligimet ndaj komunës, siç kërkohet me urdhëresën nr. 47/10, të lëshuar nga kryetari i komunës.

Konkluzioni

Kontrollet jo adekuate dhe të pamjaftueshme në lidhje me të hyrat, softuer-in dhe sistemin e faturimit, rrisin rrezikun mbi menaxhimin e të hyrave dhe manipulimet. Mungesa e një liste të detajuar dhe azhurnuar e tatimpaguesve në pronë dhe debitorëve tjerë, që sistemi softuerik duhet të gjenerojë, paraqet një sfidë shtesë.

Po ashtu, mos mbajtja e regjistrit të llogarive të arkëtueshme për të hyrat nga lejet e ndërtimit, rritë rrezikun që në pasqyra financiare, llogaritë e arkëtueshme të mos shpalosen të plota dhe të sakta.

Dhënia e vërtetimeve tatimpaguesve pa i paguar obligimet, paraqet po ashtu një dështim të kontrolleve dhe zvogëlon të hyrat e komunës.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë:

- Se Komuna do të ndërmarrë hapa në bashkëpunim me MEF-in, që departamentit të tatimit në pronë t'i mundësojë nxjerrjen e raporteve të nevojshme;
- Të përmirësojë sistemin e kontabilitetit në lidhje me evidencën e llogarive të arkëtueshme nga të hyrat e lejeve të ndërtimit;
- Të forcojë kontrollet mbi inkasimin e tatimeve dhe taksave që të njëjtat të jenë në pajtim të plotë me ngarkesat sipas aktvendimeve të lëshuara; dhe
- Respektimin e urdhëresës nr. 47/10 e lëshuar nga Kryetari i Komunës në lidhje me kushtëzimin e palëve që paraprakisht të paguajnë obligimet ligjore ndaj komunës e mandej t'i ofrohen shërbimet.

VI.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimit

Investimet kapitale për vitin 2010 për komunën e Vushtrrisë ishin 3,182,702€ dhe për çështje ekzaminimi kemi përzgjedhur një mostër gjykimi prej 1,124,357€ apo 35% të totalit. Gjatë vëzhgimeve tona kemi vërejtur:

Vonesa në ekzekutimin e punëve sipas kontratës

Te kontrata “Ndërtimi i infrastrukturës sportive dhe kulturore në Akrahticë (Lot 1-4)” në vlerë prej 164,022€ e nënshkruar më 09/11/2010 është paraparë që punimet të përfundojnë brenda 45 ditëve kalendarike. Deri në datën e auditimit, punimet ende nuk kanë përfunduar.

Dhënia e kontratës OE të papërgjegjshëm

OE i përzgjedhur për “Furnizim me karburant për automjete, ngrohje dhe gjeneratorë” në vlerë prej 99,315€ ka disponuar me licencë të MTI-së me afat të skaduar. Po ashtu, edhe validiteti i regjistrimit të automjeteve të këtij operatori ka qenë i skaduar.

Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratës

Kontrata për “ Sigurimin fizik të objekteve komunale, shkollave dhe QKMF” në Vushtrri, në vlerë prej 133,464€ është nënshkruar para se të zotohen mjetet.

Konkluzioni

Kontrollet e brendshme për sa i përket prokurimit nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme mbi mbarëvajtjen e proceseve. Dështimet në zbatimin e proceseve të prokurimit ekspozojnë komunën para rrezikut që fondet publike të jenë shpenzuar në mënyrë jo efektive dhe jo efikase.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë se proceset e prokurimit janë përmirësuar me theks të veçantë:

- Se ekzistojnë fondet e mjaftueshme për realizimin e projekteve dhe në asnjë rast Komuna nuk do të hyjë në obligime pa zotim të mjeteve;
- Se asnjë operator nuk do të shpërblehet me kontratë nëse nuk përmbushë kushtet ligjore; dhe
- Se janë analizuar vonesat në realizimin e projekteve, dhe për çdo vonesë të pa arsyeshme nga OE, janë përlllogaritur penalet sipas kontratës.

2.2 Blerjet tjera

Gjatë testimit të 40 mostrave të pagesave për mallra dhe shërbime, kemi hasur në këto mangësi:

Pagesa e shpenzimeve pa procedura të prokurimit

- Pagesa në vlerë prej 1,795€e bërë për shtypjen e materialeve të ndryshme për rastin “Takimi i Poeteshave“ ishte bërë pa kontratë dhe pa procedurë të prokurimit. Ky shpenzim është bërë me kërkesë të kryetarit, me arsyetimin e mungesës kohore për ndjekje të procedurave të prokurimit dhe
- Pagesa e faturës në emër të “Turkish Airlines“ në vlerë prej 3,120€për shpenzime – udhëtim jashtë vendit, ishte bërë pa kontratë dhe pa procedurë të prokurimit.

Mungesa e dokumentacionit mbështetës

Komuna e Vushtrrisë në vitin 2010 i kishte paguar ATK-së për dënime lidhur me kontributet pensionale për muajin shkurt 2005 vlerën prej 1,984€dhe tatim në paga për muajin qershor 2003, vlerën prej 3,166€. Komuna për pagesat e bëra nuk posedon dokumentacion mbështetës, pos një letër kujtesë për pagesë nga ATK-ja në emër të një individi.

Konkluzioni

Pagesa e shpenzimeve pa procedura të prokurimit dhe pa dëshmi të mjaftueshme, rritë rrezikun mbi rregullsinë e pagesave.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të sigurojë:

- Që çertifikimi i të gjitha shpenzimeve bëhet në pajtim me Rregullën Financiare të Thesarit -02 mbi shpenzimin e parave publike; dhe
- Respektimin (ndjekjen) e procedurave për të gjitha blerjet që bëhen përmes prokurimit.

2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti për paga dhe mëditje për vitin 2010 ishte 5,538,537€ ndërsa janë shpenzuar 5,500,157€apo 99% të buxhetit.

Gjetjet tona lidhur me testet e kryera për kategorinë paga dhe mëditje janë paraqitur më poshtë.

Pagesa të punëtorëve në shpërputhje me kontratat e punës

Në kuadër të drejtorisë së arsimit kemi identifikuar mos harmonizim në mes të koeficientëve në kontratë dhe koeficientëve të paguar në listën e pagave. Katër të punësuar në kontratë kishin koeficient 7.5 dhe një tjetër i punësuar koeficientin 8, ndërsa të njëjtit paguheshin me koeficient 9.5.

Në këtë mënyrë janë paguar prej muajit Maj 2009 deri në Gusht 2010, deri në momentin kur Administrata e Publike kishte identifikuar një parregullsi të tillë, dhe kishte kërkuar që pagat të rikthehen sipas koeficientit të vjetër. Nga këto pagesa, buxheti i komunës ishte dëmtuar për 7,098€(2,719€vetëm për periudhën janar-gusht 2010 dhe 4,379€për vitin 2009).

Pagesa retroaktive për punonjës që nuk disponojnë kontrata, por figurojnë në listën e pagave

Është paguar retroaktivisht për muajin mars dhe korrik 2010 punonjësi i cili nuk kishte kontratë. Vlera e pagesës në total për dy muaj ishte 370€

Konkluzioni

Gradimi i zyrtarëve të administratës si dhe pagesa pa kontrata valide tregon për mungesë kontrollesh. Kjo rritë rrezikun që të jenë kryer pagesa pa bazë ligjore gjë që dëmtojnë buxhetin.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë:

- Harmonizimin e koeficientëve në mes të kontratave dhe listës së pagave dhe të bëhet kthimi i mjeteve në Buxhetin e Kosovës; dhe
- Se të gjithë të punësuarit të pajisen me kontrata të punës.

VI.3 Subvencionet dhe transferet

Subvencionet e planifikuara për vitin 2010 ishin 156,010€ ndërsa janë realizuar 155,822€ Subvencionet që i paguhen përfituesit duhet bazuar në një marrëveshje zyrtare ndërmjet organizatës buxhetore dhe pranuesit. Kemi testuar 20 mostra nga kjo kategori.

Mungesa e rregullores për dhënie të subvencioneve

Subvencionet e ndara gjatë vitit 2010 nuk kanë qenë të bazuara në ndonjë rregullore e cila do të përcaktonte kushtet dhe procedurat e përfitimit të subvencioneve, mënyrën e shpenzimit dhe raportimit.

Dhënia e subvencionit pa pasur marrëveshje mirëkuptimi mes komunës dhe përfituesit

- Komuna ka subvencionuar aktivitetet e klubeve sportive në vlerë prej 3,400€ për të cilat nuk ka pasur marrëveshje mirëkuptimi mes komunës dhe përfituesve të këtyre subvencioneve. Ndaj komunës nuk është raportuar për shpenzimet e bëra nga klubet sportive.
- Për subvencionimin e OJQ-së “ARS Qendra” në Vushtrri, në vlerë prej 1,500€ për organizimin e Festivalit të Teatrit për të Rinj, po ashtu nuk ishte pranuar ndonjë raport i shpenzimeve.
- Dhënia e subvencionit në vlerë prej 5,000€produksionit filmik “SB Film Kosova” për realizimin e një filmi, kishte ndodhur pa ndonjë marrëveshje mirëkuptimi me përfituesin. Komuna nuk ka pranuar ndonjë raport për shpenzimin e mjeteve të dhëna. Projekt - buxheti i filmit për të cilin janë ndarë mjetet e lartshënuara, mban emrin e një projekti tjetër nga ai për të cilin ishin destinuar fondet.

Mungesa e dëshmive të duhura për mjetet e ndara

Komuna ka ndarë mjete në vlerë prej 1,890€për pjesëmarrjen e 7 nxënësve nga komuna e Vushtrrisë në një udhëtim për Itali, organizuar nga shkolla e muzikës “Tefta Tashko” dhe Caritas Mitrovicë. Gjatë auditimit kemi vërejtur se komuna nuk posedonte ndonjë listë të nxënësve pjesëmarrës, agjendë të udhëtimit dhe as specifikacion të shpenzimeve.

Hapja e llogarisë private në BpB për transferin e mjeteve nga komuna për kryerje të pagesave

Në llogarinë e hapur në BpB në emër të një punonjësi të komunës, sipas vendimit të komunës 02 Nr. 307/09 të dt. 07/05/2009, janë transferuar 4,891€ Më pastaj, nga kjo llogari janë paguar mëditje dhe shpenzime me rastin “Takimet e poeteshave” si dhe për aktivitete tjera.

Pagesa e bërë në para të gatshme pa dëshmi për pranimin e tyre

Pagesa e mëditjeve për 3 pjesëmarrës në “Takimet e poeteshave” nga Shqipëria, në vlerë prej 350€ është bërë në para të gatshme nga drejtori i DRKS-së. Për të njëjtat, nuk ka asnjë dëshmi për pranimin e këtyre mjeteve nga personat përkatës.

Konkluzioni

Dhënia e subvencioneve pa ndonjë marrëveshje mirëkuptimi dhe arsyeshmëri të mjaftueshme të shpenzimeve, si dhe operimi përmes llogarisë bankare në emër të individëve, rritë rrezikun e keqpërdorimit të fondeve publike.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të sigurojë:

- Hartimin e një rregulloreje, duke i specifikuar qartë të gjitha kriteret mbi ndarjen subvencioneve, , qëllimin e dhënies, monitorimin si dhe kërkesave për raportim; dhe
- Se asnjë operacion financiar nuk do të kryhet përmes llogarive private të individëve dhe se menjëherë do të bëhet transferi i parave të mbetura nga kjo llogari, në llogarinë e Thesarit.

VI.4 Pasuritë dhe Borxhet

4.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Lidhur me gjendjen e pasurive të komunës kemi identifikuar si në vijim:

- Pasuritë e komunës mbi 1,000€ nuk ishin të regjistruara në SIMFK. Evidencat mbahen në faqe Excel-i. Komisioni për vlerësim dhe inventarizim të pasurive nuk ka arritë të përfundojë punën e tij. Më tej Zyrtari i Pasurive nuk ka ndjekur trajnime përkatëse.

Konkluzioni

Mungesa e një regjistri të plotë të pasurive bën të pa mundur aplikimin e kontroleve të duhura mbi pasuritë e komunës. Kjo tregon për menaxhim të dobët të pasurive dhe rritë rrezikun për humbjen dhe keqpërdorimin e tyre.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të sigurojë që:

- Të shtojë përpjekjet për hartimin e një regjistri gjithëpërfshirës të pasurive;
- Të gjitha pasuritë me vlerë mbi 1,000€ të regjistrohen në SIMFK, dhe pasuritë tjera të përfshihen në regjistrin e pasurive;
- Çdo fundvit të bëjë inventarizimin fizik për të siguruar ekzistencën e pasurive, dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër; dhe
- Përmes trajnimeve përkatëse, Zyrtari i pasurive ka arritur shkathtësitë e nevojshme për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive.

4.2 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2010 ishte 110,880€ Këto obligime barten për pagesë në vitin buxhetor 2011. Afati i pagesës sipas Rregulla e Thesarit02 neni 44, është brenda 30 ditëve kalendarike prej pranimit të faturës së dorëzuar në mënyrë të duhur.

Konkluzioni

Mungesa e disiplinës financiare mbi detyrimet, e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për kontrollë dhe marrjen e vendimeve të drejta dhe efektive. Për pasojë, për obligimet e papaguara mund të lindin edhe konteste gjyqësore të cilat vështirësojnë stabilitetin buxhetor të komunës.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të sigurojë se:

- Të gjitha obligimet e papaguara gjatë vitit, do të jenë prioritet i pagesave në vitin 2011.

VII.Kontrolli mbi menaxhimin

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Të gjeturat e mësipërme janë tregues se kontrollet e brendshme nuk janë të mjaftueshme për të ofruar një siguri të arsyeshme se sistemet dhe politikat e vendosura nga ana e menaxhmentit janë duke funksionuar si duhet. Masa përmirësuese të kontrolleve duhet të merren në të gjitha fushat, si në menaxhimin financiar ashtu edhe tek forcimi i kontrolleve të përgjithshme.

Forcim i masave të kontrollit nevojitet, sidomos tek menaxhimi i të hyrave, shfrytëzimi i subvencioneve dhe menaxhimi i pasurive.

VII.2 Auditimi i Brendshëm

NJAB funksionon me dy auditorë, disponon planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit.

Kjo njësi ka kryer katër auditime në vitin 2010. Auditimet e kryera janë: Rishikimi i proceseve të Prokurimit; Kontrolli i brendshëm në drejtorinë e Thesarit, buxhetit dhe financave, Furnizimi me derivate të naftës dhe Subvencionimi i entiteteve publike dhe jopublike.

Tre prej tyre kishin si fushëveprim aktivitetet e vitit 2009. Ndërsa raporti në lidhje me furnizimin me derivate të naftës për institucionet e komunës mbulonte periudhën qershor-gusht 2010.

Raportet e kryera nga NJAB kishin përfshirë fushat me rrezik të lartë.

Komuna në vitin 2008, kishte formuar Komitetin të Auditimit në përbërje prej 5 (pesë) anëtarësh. Ky komitet, gjatë vitit 2010 nuk ishte funksional. Komuna vendos që në dhjetor 2010 ta riformojë Komitetin e Auditimit në përbërje prej 3(tre) anëtarëve.

Konkluzion

Mos kryerja e auditimeve që si fushëveprim kanë vitin 2010, nuk ofrojnë sigurinë e duhur për menaxhmentin, lidhur me funksionimin e kontrollës së brendshme .

Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit e zvogëlon rolin që e luan si një mekanizëm i fortë në mbikëqyrjen e menaxhimit efikas dhe efektiv të komunës si dhe të ndihmojë menaxhmentin në vendimmarrje.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të sigurojë që:

- NJAB të kryen më shumë auditime për periudhën aktuale (brenda vitit fiskal);
- Që Komiteti i Auditimit të jetë funksional dhe të zhvillojë aktivitete dhe detyra që i ka të përcaktuara sipas UA 11/2010.

VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës

Konkluzionet e përgjithshme

Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit është se menaxhmenti i komunës ka qenë mjaft efektiv në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit. Shkalla e realizimit buxhetor prej 95% paraqet një performancë shumë të mirë menaxheriale. Megjithatë, raporti ka identifikuar shumë mangësi dhe dobësi. Ato janë të natyrës së kontrollit financiar, kontrollit të prokurimeve si dhe të menaxhimit në përgjithësi.

Më tutje, mangësitë në aspektin e raportimit, cilësia e informatave dhe dobësitë në menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive, po ashtu paraqesin sfida me të cilat menaxhmenti duhet të merret seriozisht.

Rekomandimi i përgjithshëm

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që:

- Pas analizës së hollësishme të gjetjeve të këtij raporti, të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të vendosur masa adekuate dhe përmbushur rekomandimet e këtij raporti. Një plan veprimi i specifikuar me afate kohore dhe bartësit e detyrave, do të ishte mekanizmi kryesor për arritjen këtyre objektivave.

Shtojca I. Komentet e Komunës së Vushtrrisë dhe përgjigjja e ZAP-it

Menaxhmenti i Komunës së Vushtrrisë i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2010 dhe është zotuar që do ti bëjë përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpallje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor

nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinioneve. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksioneve të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionin i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.